REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 02/17
Datë/Datum. 14.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 02/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Tefik Sylejmani - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Intering Sh.p.k" - Prishtinë, kundër AK–/Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Riparimi, liferimi dhe montimi i termoizolimit", me nr prok:"16/348/521", më datën 09.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "Intering Sh.p.k - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Riparimi, liferimi dhe montimi i termoizolimit", me nr prok:"16/348/521", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/.

II. **Anulohet,** vendimi i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi, liferimi dhe montimi i termoizolimit", me nr prok: "16/348/521" dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "Intering Sh.p.k" - Prishtinë, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:21.10.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:14.11.2016, ku kanë marr pjesë pesë peratorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:21.12.2016, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Ar Tech shpk&Izovent" - Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Intering" Sh.p.k" - Prishtinë me dt:27.12.2016, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:30.12.2016 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Intering" Sh.p.k" - Prishtinë

I pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Operatori ekonomik "Intering" Sh.p.k - Prishtinë, ka deponuar ankesë në OSHP, më 05 janar 2017 me nr. 02/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Riparimi, liferimi dhe montimi i termoizolimit", me nr prok: "16/348/521", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së –Qëllimi i Ligjit
- Neni 6 i LPP-së –Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 39 i LPP së –Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik-Sqarimet e tenderëve
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- Neni 60 i LPP-së –Kriteret për dhënie të kontratës
- Neni 69 i LPP-së –Aftësia teknike dhe profesionale
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108 i LPP-së –Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 30 janar 2017, gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit: "Riparimi, liferimi dhe montimi i termoizolimit", me nr prok:"16/348/521", i ka rekomanduar panelit shqyrtues qe ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të aprovohet e bazuar, ndërsa Autoriteti Kontraktues të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës të datës 21.12.2016, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik ankues "Intering" Sh.p.k - Prishtinë, me datë: 31 janar 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 02 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 09.02.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Intering" Shpk- Prishtinë ka deklaruar: "Unë përfaqësoj OE Intering, referuesi tha shumë mirë, nuk dua të marr kohë më shumë. Çështja kontestuese, ne si OE pajtohemi me çdo gjë deri sa ka ardh te çështja e sqarimit të ofertave sipas nenit 72. AK ka vepruar drejt dhe ka kërkuar sqarim për të vetmin dokument kontestues. Kërkesa është bërë me 08.12.2016 dhe është kërkuar të sqarohet një emër që është vendos në kërkesën e dosjes tenderike. Kërkesa për sqarim është këtu "Për të vlerësuar tenderin e juaj kërkojmë të sqaroni në pikën si në vijim "në ofertën tuaj tabelën pjesa 3, prejardhja e mallrave të ofruara keni cek se një nga ofruesit e mundshëm është edhe prodhuesi Tacke Lindeman, konform nenit 72 të LPP-së kërkojmë të na dërgoni linkun ku është publikuar certifikata ISO 9001 e prodhuesit". Ne si OE me kohë kemi kthyer përgjigje dhe shumë të qartë dhe të kuptueshme si

vijon "Dëshirojmë të ju sqarojmë se Tack Lindeman është kompani furnizuese në tregun gjerman që përfaqëson kompani të ndryshme prodhuese. Po ashtu kemi bashkëpunim shumëvjeçar me këtë kompani për furnizim me materiale për termoizolime për punët që kryhen nga kompania jonë në Evropë dhe Kosovë. Prodhuesit e përmendur në pjesën 3 të formuarin për dorëzimin e tenderit i përmbushin gjitha kërkesat për furnizim sipas këtij tenderi" dhe janë përmendur në vazhdim emrat e katër prodhuesve. Bazuar në nenin 72 të LPP-së 05L/068 po ju dorëzojmë si shtesë dhe dokumentet shtesë për deklaratën e Tacke Lindmean. Është e vetmja pikë kontestuese. OE kur ka përmend emrat dhe ka përmend katër prodhues ku i ka bashkangjitur katër certifikatat ISO të prodhuesve. Në këtë listë të katërve ka mbet edhe emri i shpërndarësi Tacke Lindeman, dhe sqarimi është shumë i plotë se Tacvke Lindeman është shpërndarës e jo prodhues, dhe gjitha kërkesat e dosjes përmbushen nga katër prodhuesit tjerë. Ndoshta nuk është dashtë të përmendet emri shpërndarësit mirëpo çdo kërkesë plotësohet nga prodhuesit bile më shumë nga ajo çka AK ka kërkuar. Ecurit tjera janë sipas ligjit, dhe pas AK i jemi drejtuar OSHP dhe eksperti ka dhënë mendimin e drejtë lidhur me gjendjen e konstatuar. Gjitha shkresat e lëndës gjenden në lëndë dhe nuk do merrja kohë më shumë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: "Ne si AK vlerësojmë se i jemi përmbajtur gjitha ligjeve në fuqi si dhe konstatimet ose pretendimet e OE ankues dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të pabaza. OE ankues është deklaruar se konstatimi 3 i ekspertit është gabim teknik. Në konstatimin 3 eksperti ka konstatuar se përgjigjen e pranuar me datë 13.12.2016 AK-KEK i ka pranuar ISO certifikatat e kërkuara, gjë të cilën e ka demontuar vet ankuesi. AK ka qenë shumë i qartë në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të datës 30.12.2016, ku konstaton se njëri nga prodhuesit e potencuar në ofertën e OE ankues Intering në tabelën pjesa 3 prejardhja mallrave të ofruara është prodhuesi Tacke Lindeman. Në përgjigjen e OE ankues kemi sjellur sqarimin se Tacke Lindeman nuk është prodhues por distributor andaj nuk ka ISO certifikatë. Sipas nenit 59.2 ku ndër tjera thuhet "Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohet ose pranohet nga AK" si dhe "OE ankues e ka vulosur dhe nënshkruar deklaratën nën betim ku pranon gjitha sanksionet nëse ndonjë informatë është përmbajtësish e gabueshme ose mashtruese. Në rastin tonë a është e gabueshme apo mashtruese nuk e di, mirëpo faktet janë në letra. Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së ka deklaruar: "Gjatë shqyrtimit dhe analizimit të këtij aktiviteti AK-KEK ka kërkuar konform neni 72 të LPP nga OE Intering që të sqaroj dhe të plotësoj certifikatat ISO për furnizimin e këtyre materialeve". OE Intering ka plotësuar certifikatat dhe ka ofruar sipas kriterit të AK-së pika 9.1 dhe 9.2. Un kam cek edhe te sqarimi nr.3 se OE ankues Intering ka një bashkëpunim me kompaninë Tacke Lindeman, dhe për faktin ka sjell dëshmi me certifikatat ISO të këtyre kompanive, dhe mendoj se OE ka plotësuar këtë kriter me certifikatat ISO dhe ka qenë më i lirë.

Njëri nga anëtarët e panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së, se çfarë certifikata keni kërkuar dhe sa certifikata të prodhuesve ka ofruar OE ankues pos kësaj që kontestoni?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "Pjesën tre OE është deklaruar për Tacke Lindeman dhe për kompani nuk ka ofruar as në ofertë, as në pyetje sqaruese dhe të njëjtën thënë time argumenton në përgjigje të kërkesës për sqarime.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "Është kërkuar certifikata nga prodhuesi i OE Intering i ka përmend pesë emra. Prej këtyre katër janë prodhues dhe një emër është vendos i cili është distributor. Tacke Lindeman është distributor dhe nuk është prodhues. Së bashku janë edhe katër prodhues tjerë për cilët janë katër certifikata. Këta katër prodhues janë Knauf, Husen Group, Sab Profil dhe Tata Steel. Për gjithë këta janë certifikata në rregull dhe valide. OE as nuk e ka vënë në lajthitje AK-në, as nuk e ka mashtruar dhe shumë mirë dhe qartë i ka dhënë përgjigje –sqarim AK-së. I vetmi defekt është se ka mbet emri i distributorit si prodhues, dhe kjo i është sqaruar AK-së. Po mos të ishte emri Tacke, i cili nuk e ndryshon asnjë milimetër tenderin, oferta e OE ankues 100% plotëson kërkesat e dosjes. Kërkojmë nga paneli shqyrtues të merr një vendim meritor dhe të përdor nenin ku është vlerësimi i ofertave të disiplinoj komisionin vlerësues, dhe në fund të kthej lëndën në Rivlerësim".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: "Në ofertë të OE ankues, kompania Tacke Lindeman si çka është prezantuar në tabelën pjesa tre. Kërkojmë nga paneli shqyrtues të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar".

Në fund eksperti shqyrtues deklaroj:"Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në ekspertizë".

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues se nuk ka plotësuar kërkesën në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale, e ku është kërkuar kopja e certifikatës ISO 9001:2008 të prodhuesit për produktet e ofruara, Paneli shqyrtues lidhur me këtë sqaron se AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së nga operatori ekonomik ankues, ndërsa i njëjti operator ekonomik me dt:13.12.2016 i ka sqaruar autoritetit kontraktues duke e plotësuar ofertën me katër certifikata ISO të prodhuesve të cilët e plotësojnë kërkesën e FDT-së, ndërsa ka dorëzuar si shtesë edhe dokumentet për deklaratën e kompanisë "Tacke Lindemann"-Gjermani ku ka sqaruar se kjo kompani është furnizues-shpërndarës e jo prodhues. Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet e larpcekura rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, pasi që nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit dhe njëkohësisht me rastin e rekomandimit për kontratë nuk e ka respektuar nenin 60 kriterin kryesor për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimit i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, duke u cenuar edhe neni 1 i LPP-së, pasi që nuk është marr parasysh qëllimi i Ligjit për prokurim publik e që është sigurimi i mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Poashtu paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka marr parasysh nenin 6 të LPP-së, ku parashihet që të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike. Paneli shqyrtues konstaton se është eliminuar operatori ekonomik ankues i cili pas sqarimeve shtesë dhe plotësime që janë bërë konform nenit 72 të LPP-së, rezulton që i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke ofertuar me çmim më të lirë se OE i rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZË

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE – "Intering Shpk"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.